
TRIBUNA SINDIKALE

Shtator 2005

Dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë





Editorial

VIT I OBJEKTIVAVE TE MEDHA

Viti i Ri shkollor 2005-2006 filloi me 19 shtator marshimin e tij te gjate. Popull i yre, i etur per kulture e dije, tradicionalisht e ka kthyer kete dite ne nje feste te vertete. Ka, ne kete dite, gezim per femijet dhe prinderit, por edhe respekt e nderim per mesuesit dhe punen e tyre.

Ky eshte nje vit me objektiva te medha per zhvillimin, modernizimin dhe demokratizimin e arsimit, per ngritjen e cilesise se punes ne shkolle. Ky eshte nje vit me objektiva e angazhime te medha edhe per sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH., qe kane luajtur dhe luajne nje rol te pazevendesueshem, si partnere sociale ligjore ne marredheniet me punedhenesin, me Ministrine e Arsimit e Shkences dhe me Qeverine.

Objektivi i pare i sindikatave, per kete vit, eshte realizimi i Marreveshjes per rritjen e pagave te mesuesve te te gjithe sistemit parauniversitar ne masen 15 perqind, duke filluar nga 1 shtatori 2005.

Kjo Marreveshje erdhi si rezultat i presionit dhe veprimeve te vendosura sindikale. Vonesa ne realizimin e saj u shkaktua nga zgjatja e procesit zgjedhor, ku vendi praktikisht ishte pa qeverisje per afro tre muaj. FSASH do te filloje, brenda pak ditesh, negocimet me MASH dhe me Qeverine per zbatimin e kerkesave qe permban Marreveshja. Me kete rast, theksojme se FSASH nuk ka vene kurre dhe as nuk ve ne dyshim realizimin e kesaj Marreveshjeje, sepse rritja e pagave ne masen 15 perqind per arsimin parauniversitar eshte modeste dhe plotesisht e zbatueshme.

Objektivi i dyte dhe shume i rendesishem eshte vazhdimi i negocimeve dhe nenshkrimi i Kontrates se re Kolektive te Punes. Qe ne pranevere te ketij viti jane ngritur grupet e punes nga sindikatat dhe nga Ministria e Arsimit, te cilet kane punuar mbi bazen e Kontrates ekzistuese. Ne vazhdim, brenda shtatorit, do te rifillojne kontaktet me Ministrine e Arsimit, me qellim qe te krijohen kushtet per vazhdimin e punes ne nivelet teknike per pergatitjen e draftit perfundimtar.

Por, derisa te nenshkruhet Kontrata e re, eshte ne fuqi Kontratra kolektive ekzistuese, sepse, megjithese formalisht ajo duhej te perfundonte me 31 gusht 2005, asnje pale nuk e ka denoncuar ate dhe, per pasoje, ajo vazhdon te prodhoje efekte ligjore dhe eshte plotesisht ne fuqi.

Objektivi i trete per kete vit shkollor mbetet hartimi i draftit perfundimtar per Statusin e Mesuesit. Deri tani eshte bere nje pune pergatitore nga te dy partneret, nga Sindikatat dhe nga MASH, por ky proces duhet intensifikuar.

Natyrisht, FSASH dhe SPASH kane edhe objektiva te tjera te brendshme qe lidhen me funksionimin statutor te strukturave te tyre nga baza deri ne qender, me kualifikimin sindikal e profesional te aktivit te zgjedhur, me permiresimin e punes me grate dhe te rinjte sindikaliste, etj.

PERMBAJTJA

- Editorial: Vit i objektivave te medha 2
- Pershendetje me rastin e fillimit te vitit te ri shkollor 3
- Aktivtetet te shoqerohen me rezultate konkrete (Projekti AOB-FNV) 4
- 5 Tetori, Dita Boterore e Mesueseve 5
- Nga Rekomandimet i ILO - UNESCO mbi Statusin e Mesuesit 7
- Nga aktivitetet e FSASH 8
- Nga aktivitetet e SPASH 11
- Federata e Mesueve te Pensilvanise 11
- Fushat e veprimit te sindikatave per te eliminuar punen e femijeve 12
- Kur nis viti ri arsimor.., *nga Murat Gecaj* 13
- Të reja shkencore dhe këshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Gëzimi i vogëlushve
në ditën e parë të shkollës
Kopertina e fundit:
Ora e parë e mësimit
për vitin shkollor 2005-2006

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 15, Periodike
Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi " Zogu i Pare "
Pallati Ali Kelmendi, kati III,
Tel: 22 83 46
Tel & Fax: 25 65 32

Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

Pershendetje me rastin e fillimit te vitit te ri shkollor

Pershendetje e Z. GENC POLLO, Ministeri i Arsimit dhe Shkences



Te dashur nxenes,
Te respektuar prinder,
Te nderuar mesues,
Miq te arsimit kudo,
Neser zbardh nje dite e ndryshme nga te tjerat. Neser fillon viti i ri shkollor.

Sonte prinder e femije do t'i japin, jo pa emocion, doren e fundit pergatitjeve, qe neser te nisen siç duhet ne shkolle.

Nje urim veçanerisht te ngrohte per ata dhe prinderit e tyre, veçanerisht per nxenesit e klases se pare!

Ne shpresojme shume nga shkolla.

Ne e dime se nje shoqeri eshte demokratike kur perbehet nga qytetar demokrate te formuar permes arsimit te duhur.

Ne e dime se nje shoqeri zhvillohet ekonomikisht kur ka njerez me dije dhe aftesi profesionale.

Ne e dime se ilaçi me i mire kunder varferise se shume familjeve eshte arsimi i duhur per femijet e tyre. Prandaj qeveria e re e ka veçuar arsimin si nje perparesi kryesore te saj. Per te ne kemi nje program te qarte e te realizueshem, te cilin do t'a çojme deri ne fund, se bashku me nxenes, mesues, miq te arsimit e partnere te huaj. Kete do ta bejme me dyfishimin e buxhetit te arsimit e te pagave te mesuesve, por, njekohesisht, duke kerkuar cilesi, korrektese e transparence.

Do te mundesojme qe çdo femije te ulet nje dite ne bankat e shkolles dhe te qendroje aty nente vjet.

Gjithashtu do te realizojme gjimnaze me klasa normale, tekste nxitese, mesimdhenie moderne, si edhe shume shkolla profesionale.

Pra, kemi shume pune per te bere ne te mire te secilit dhe te te gjitheve.

Dita e pare e shkolles eshte nje shenje e mbare fillimi.

Gezuar te gjitheve kete dite!

Pershendetje e Z. XHAFER DOBRUSHI, Kryetar i FSASH

Vit te mbare, kolege te nderuar

19 shtatori erdhi. Nje armate e madhe prej 700 mije nxenesish dhe 35 mije mesuesish nisen ne kete dite "betejen" njevjeçare per arsim, kulture e dije. Kjo dite eshte bere prej kohesh nje feste tradicionale. Eshte feste per 55 mije vogelushet qe ulen per here te pare ne bankat e shkolles, feste per nxenesit dhe per mesuesit, feste per prinderit dhe gjithe qytetaret.

Ne kete dite te gezuar, ne emer te FSASH, uroj perzemersisht mesuesit dhe nxenesit: Nje vit te mbare, plot pune dhe suksese!

Me kete rast, pershendes vecanerisht sindikalistet anetare te FSASH dhe i siguroj ata se Federata e tyre, si gjithnje, me qartesine, vendosmerine, guximin dhe pjekurine qe e karakterizon, do te jete, edhe ne kete vit te ri shkollor, ne balle te luftes e perpjekjeve per plotesimin e kerkesave te tyre te drejta ekonomike e sociale, per zhvillimin e reformes dhe modernizimin e demokratizimin e gjithe sistemit arsimor.

Edhe njehere: Gezuar festen dhe pune te mbare, te nderuar kolege mesues e sindikaliste dhe ju te dashur nxenes!



Pershendetje e Z. BAJRAM KRUJA, Kryetar i SPASH



Të dashur nxënës,

Ju uroj fillim të mbarë të vitit shkollor. Dëshira juaj për të mësuar është shumë e madhe, por ju nuk duhet të dekurajoheni nga mangësitë, gjendja e disa klasave, librat, dritat e sidomos vështirësitë ekonomike. Mësoni, mësoni e vetëm mësoni, se bëheni të vlefshëm për vehten tuaj, familjet tuaja dhe vendin tonë.

Të dashur prindër,

Është e vërtetë se ndryshimet e mëdha në Shqipëri pas viteve '90 kanë vënë në provë krizën në familje. Ekonomia e tregut na zuri të papërgatitur të gjithëve, por duket se shqiptarët e kanë në gjak dëshirën për të arsimuar fëmijët. Sakrifikoni sa të keni mundësi dhe me durimin tuaj, kapërceni vështirësitë ekonomike dhe arsimoni fëmijët.

Të dashur kolegë mësues,

Gjatë këtyre 15 viteve të demokracisë ju jeni përballur me të pa përballueshmen dhe kini fituar, në klasa pa banka, me autobuza pa xhama, fëmijë pa libra etj, etj. Edhe sot në shumë shkolla ka nevoja të mëdha. Kërkesat tona në rritje do të jenë për të pasur një vlerësim moral nga shoqëria e material nga shteti.

Të nderuar shtetarë,

Ne kemi punë të vështirë. Na vlerësoni! Që në lashtësi është shkruajtur për profesionin tonë: ja ç'thotë Ciceroni: "Cili profesion fisnik është më i vlefshëm se sa i njeriut që edukon brezin që rritet?"

Ne ju urojmë të gjithëve punë të mbarë! Ne do të punojmë dhe do t'ju ndihmojmë që premtimet e marra t'i bëjmë realitet.

Aktivtetet te shoqerohen me rezultate konkrete

Nga zbatimi i Projektit me AOB-FNV

Ne vazhdim te zbatimit te Projektit "Fuqizimi i sindikatave shqiptare dhe rritja e kapacitetit te tyre per eliminimin e punes se femijeve", FSASH dhe SPASH jane te angazhuara, jo vetem per organizimin e aktiviteteve qe jane parashikuar ne planin e punes per periudhen ne vijim, por, sidomos, per realizimin e objektivave qe ato kane vendosur ne kuadrin e ketij Projekti.

qe do te zhvillohet ne datat 13, 14, 15 tetor 2005, ne lidhje me angazhimin e mesuesve per shmangien e braktisjes se shkolles dhe eliminimin e punes se femijeve. Seminari do te jete nje aktivitet pergjithesues e udhezues, qe vjen pas nje pune konkrete qe eshte bere ne disa shkolla te ketij rrethi per evidentimin e nxenesve qe kane braktisur shkollen ose jane ne rrezik per ta braktisur ate,

tivitete keto qe pritet te shoqerohen me rritjen e numrit te anetareve nga radhet e ketyre kategorive.

Te gjitha keto aktivitete, si edhe çeshtje te tjera te rendesishme te veprimtarive sindikale te FSASH e SPASH do te pasqyrohen gjeresisht ne Revisten "Tribuna Sindikale", e cila do te vazhdoje te botohet rregullisht. Ne numrat e ardhshem te saj, gjate ketij viti, do te zene me shume



Me kete synim, do te mblidhen grupet e punes, ku do te behet nje bilanc i arritjeve dhe do te diskutohet per disa nga detyrat kryesore qe do te ndiqen gjate periudhes deri ne fund te ketij viti e ne vazhdim.

Ne Elbasan kjo pune do te shoqerohet edhe me masat qe do te merren per organizimin e seminarit

si edhe per rikthimin e tyre ne shkolle.

Puna me grate dhe mesuesit e rinj do te vazhdoje te jete nje nder drejtimet e rendesishme te FSASH e SPASH ne kuadrin e ketij Projekti. Per kete qellim, gjate muajit tetor do te organizohen takime me grupet e punes dhe, gjate mentorit, do te mblidhen drejtuesit lokale respektive, ak-

vend edhe pervoja e problemet e seksioneve sindikale ne rrethe dhe keshillave sindikale ne shkolla.

Njohjes se objektivave, aktiviteteve, problemeve si edhe praktikave te mira, do t'i sherbeje, gjithashtu, edhe broshura qe pritet te pergatitet e botohet ne kuadrin e ketij Projekti.

5 Tetori, Dita Boterore e Mesueseve

5 Tetori, njihet tashme nga te gjithe si Dita Boterore e Mesuesit. Organizata e Kombeve te Bashkuara per Arsimin dhe Shkencen, UNESCO, e ka percaktuar, ne vitin 1994, 5 Tetorin si Diten Boterore te Mesuesve, per te perkujtuar nenshkrimin e Rekomandimit, ne lidhje me Statusin e Mesuesve, miratuar me 5 Tetor 1966. Dita Boterore e Mesuesit evidenton, gjithashtu, Rekomandimin ne lidhje me Statusin e Personelit te Arsimit te Larte, te miratuar ne vitin 1997.

Synimi i shpalljes se 5 Tetorit si Dita Boterore e Mesuesve ne te gjithe Globin, eshte venia ne dukje e rolit te jashtezakonshem te mesuesve per arsimimin dhe edukimin e gjithanshem te femijeve e studenteve qe jane e ardhmja e çdo vendi.

Synimi i Dites Boterore te Mesuesit eshte qe te evidentoje rolin e mesuesve kudo ne bote, si edhe te bind vete mesuesit per rendesine e madhe dhe rolin e pazevendesueshem qe ata luajne ne shoqeri.

Eshte per kete arsye qe Internacionalja e Arsimit, EI, ka disa vjet qe ka ndermarre nje fushate te gjere per vleresimin dhe propagandimin e kesaj Dite. Si rrjedhoje, mbi 100 vende ne bote e vleresojne Diten Boterore te Mesuesit. Ajo eshte nje mundesi e madhe per te evidentuar sfidat me te cilat perballen mesuesit si edhe rendesine e trajnimit te mesueve

Me 5 tetor organizatat e mesuesve kudo ne bote mobilizohen per te siguruar qe nevojat e gjenerates se ardhshme te merren ne konsiderate ne kete bote komplekse, shumekulturore dhe me teknologji ne rritje.

Cdo vit EI ka ndermarre fushata per ndergjegjsimin publik per te evidentuar kontributin e profesionit te mesuesit. "Mesuesit-dyer te hapura per nje bote me te mire" ishte parulla e kesaj Dite per vitin 2003. Kjo ilustron me se miri se mesuesit jane shtylla e arsimit; ata ndikojne qe tek nxenesit te zhvillohen shkathtesite me te domosdoshme, qe ata te perfitojne vlerat me te mira njerezore; qe ata te hapin perspektiva, mundesi dhe shpresa te reja per secilin. "Mesues cilesor per arsimim cilesor" ishte parulla e kesaj Dite per vitin 2004, duke synuar te mbuloje nje sfere te gjere çeshtjesh qe lidhen me ngritjen cilesore te nivelit te mesueve.



"Trajnim per nje force mesimdhenese me te fuqishme" eshte slogani i Dites Boterore te Mesuesit per vitin 2005. Kete vit, EI do te perqendrohet te nevoja per te siguruar mundesi me te mira per trajnimin e mesueve, perpara se ata te hyjne ne klase per te dhene mesim. Cilesia e trajnimit te mesueve ka nje ndikim kritik dhe afatgjate per cilesine e arsimimit. EI beson se arsimimi i mesueve duhet te perfshije edhe trajnimin baze cilesor, ne menyre qe mesuesit te kene nje formim teorik e praktik dhe te pajisen me metodologji bashkekohore te ketij profesioni jetik per çdo shoqeri. Trajnimi i mesueve ka nje efekt afatgjate mbi cilesine e arsimit. Mesuesit kane nevoje per:

- Trajnim ne lidhje me çeshtjet akademike, shkencat arsimore metodologjine, didaktikat dhe praktikat e mesimdhenies.
- Trajnim mbi detyrat te cilat formojne nje pjese te shkathtesive qe kerkohen nga mesuesit aktualisht, per te punuar si anetar te nje grupi (skuadre), per te zgjeruar kontaktet me prinderit dhe institucionet lokale, per nje pjesemarrje te gjere ne aktivitetet kerkimore dhe ne administrimin e institucioneve arsimore.
- Trajnimi ne vendin e punes, modernizimi i teknologjive te informacionit dhe komunikimit dhe zhvillimi profesional, per te ngritur dhe pershtatur aftesite e mesuesve, ne perputhje me kerkesat e kohes.

EI i permbahet opinionit se shteti eshte aktori kryesor per te arritur te gjitha keto synime, prandaj:

- Trajnimi i mesueve duhet te jete nje pjese plotesisht e integruar e politikave kombetare te arsimit, duke reflektuar diversitetet ekzistuese kulturore.
- Mesuesit duhet te kontribuojne per politikat qe u perkasin trajnimit te tyre dhe zhvillimit profesional te tyre.
- Duhet te vendoset nje dialog me efektiv midis institucioneve qe merren me pergatitjen e mesueve, shtetit dhe organizatave te mesueve.
- Duhet te inkurajohen perpjekjet kombetare ne te gjitha keto drejtime.

EI synon te krijoje ura lidhese midis trajnimit dhe mesimdhenies ne praktike.

Per kete:

- Te gjitha kategorite e mesueve, ne te gjitha nivelet, duhet te kene arsimim te nevojshem cilesor, trajnim te vazhdueshem ne vendin e punes, si edhe arsimim te vazhdueshem, me qellim qe te kontribuojne ne zhvillimin e tyre profesional dhe te ruajne standarde te larta ne profesion.
- Qeverite dhe autoritetet arsimore perkatese duhet te sigurojne mundesi arsimimi dhe pergatitjeje profesionale te cilesive te larta per te gjithe mesuesit.
- Trajnimi cilesor fuqizon statusin e mesuesve!

EI e konsideron themelor arsimimin per profesionin e mesuesit, sepse:

- Ky arsimim dhe trajnimi ne vendin e punes i pajisin mesuesit me njohurite

Vijon në faqen 6

5 Tetori, Dita Boterore e Mesueseve

Vijon nga faqja 5

baze teorike e akademike dhe i praktikon ata me metodologjite e mesimdhenies, te cilat jane bazat e ketij profesioni.

- Mesuesit duhet te pajisen me nivelin me te larte te arsimit profesional perkates.

Me rastin e Dites Boterore te Mesuesit, dy organizmat me te medha sindikale boterore, Internacionalja e Arsimit, EI, dhe Konfederata Boterore e Mesuesve, WCT, kane publikuar nje Deklarate te perbashket me titull:



Mesuesit-dyer te hapura per nje bote me te mire, ku, nder te tjera, thuhet:

Qe prej shume kohesh, ne cdo shoqeri njerezore ka pasur te tille qe kane hapur dyert e njohurive; ata quhen mesues.

Mendimi me revolucionar i koheve moderne eshte "Arsimim per te Gjithe". Dhe ata qe kane pergjegjesine e dyereve te hapura per te gjithe, jane mesuesit.

Keshtu mesimdhenia eshte nje profesion qe nuk i sherben vetem nje pakice te privilegjuar, por cdo komuniteti, te pasur e te varfer, ne qytete, ne rrethina e ne fshatra.

Hapi i pare drejt nje bote me te mire eshte te siguroje Arsimim per te Gjithe, ne te gjitha kombet. Pa diskriminim per shkak te races, te origjines kombetare, te besimit fetar, ose te gjinise, shendetit, shkalles se varferise; te gjithe duhet te kene mundesine te realizojne endrrat e tyre ose te japin kontributin e tyre ne komunitetin ku jetojne. Gjithkush ka te drejten e arsimimit, shpalle Deklarata Universale e te Drejtave te Njeriut.

Se dyti, shoqerite tona duhet te njohin rolin kyc te atyre qe hapin dyerte, pra, te mesuesve. Ata duhet te jene te kualifikuar dhe duhet t'u jepen mjetet qe te sigurojne Arsimim cilesor per te gjithe.

Se treti, ne duhet te konfirmojme qe hapja e dyereve per nje bote me te mire, do te thote te pergatiten te rinj qe te jene qytetare, te jene pjesemarres aktive e pergjegjes ne shoqerite demokratike. Ne nuk duhet te lejojme qe te rinjte te terhiqen ne shtigjet e intolerances, unrejtjes dhe dhunes.

Ne kemi nevoje per mesues, mesues reale dhe jo zevendesues. Ne duhet t'i inkurajojme e t'i mbajme mesuesit ekzistues dhe te terheqim te rinj, njerez te perkushtuar, qe te jene dyer te hapura te se ardhmes.

Dita Boterore e Mesuesit eshte nje rast per te riafirmuar besimin tone ne perspektiven e progresit drejt nje bote me te mire dhe vleresimin per kontributin e hapesve te dyereve, mesuesve.

Vleresim edhe nga FSASH e SPASH

Duke vleresuar rendesine e kesaj Dite, edhe sindikatat shqiptare te arsimit, FSASH e SPASH, kane insistuar qe 5 Tetori te konsiderohet e te vlereshet nga shkollat, institucionet perkatese arsimore dhe vete sindikatat.

Eshte per kete arsye qe edhe ne Kontraten Kolektive te Punes ne fuqi, Neni 13.8 percakton se: "5 Tetori, Dita Boterore e Mesuesve, do te jete ne te gjithe vendin dite veprimtarish kushtuar kesaj Feste".

Me kete rast, FSASH e SPASH, kane shperndare materiale te posacme per te ndergjegjsuar mesuesit dhe sindikatat ne shkolla per vleresimin e kesaj Dite, si nje rikonsiderim i rolit te mesuesve ne shoqerine tone.

Nderkohe, Seksionet sindikale ne disa rrethe do te organizojne aktivitete te posacme me pjesemarrjen e mesuesve e sindikalisteve, ku do te flitet per rolin e mesuesve, detyrat e sindikatave dhe nevojen per nje vleresim me te mire te figures se mesuesit ne shkolle e ne shoqeri nga ana e shtetit.

FSASH mban parasysh Rekomandimet e EI, ne zbatim te Rezolutes se vitit 2001 mbi Partneritetin per te Arritur Arsimimin per te Gjithe, te cilat jane:

- Sindikatat e mesuesve te marrin kontakte me Ministrine e Arsimit dhe Drejtorite Arsimore, te krijojne me to partneritet per te realizuar se bashku objektivat e "Arsimim per te Gjithe",

- Ministria dhe Drejtorite Arsimore te vendosin mekanizmin e informacionit e te konsultimeve, si edhe negocimet qe synojne ne permiresimin e pagave e te kushteve te punes te mesuesve, si edhe materialet burimore per mesimdhenien, pajisjet e shkolles, kualifikimin e mesuesve e te personelit arsimor ne pergjithesi.

- Shkollat te bazohen ne pjesemarrjen demokratike dhe aktive ne shoqerine civile, nepermjet nje partneriteti real, per te perpunuar menyra te reja te bashkepunimit midis shkolles, prinderve, sindikates dhe sektoreve te ndryshem te komunitetit.

Pergatiti
Stavri LIKO

Nga Rekomandimet e ILO-UNESCO mbi Statusin e Mësuesit

Të drejtat dhe detyrimet e mësuesve

Liria profesionale

61. Profesioni i mësuesit duhet të gëzojë liri akademike në kryerjen e detyrave profesionale. Përderi sa mësuesit janë veçanërisht të kualifikuar për të gjykuar cilat janë metodat dhe mjetet mësimdhënëse më të përshtatshme për nxënësit e tyre, atyre duhet t'u jepet roli primar në zgjedhjen dhe përshtatjen e materialit mësimor, në zgjedhjen e teksteve mësimore dhe aplikimin e metodave mësimdhënëse, brenda kuadrit të programeve të aprovuara dhe me ndihmën e autoriteteve arsimore.

62. Mësuesit dhe organizatata e tyre duhet të marrin pjesë në krijimin e lëndëve, teksteve dhe mjeteve ndihmëse mësimore të reja.

63. Çdo sistem inspektimi apo mbikqyrjeje duhet të ketë formë të tillë që të nxisë dhe ndihmojë mësuesit në kryerjen e detyrave të tyre profesionale dhe duhet të jetë i tillë që të mos pakësojë lirinë, iniciativën dhe përgjegjësinë e mësuesve.

64. (1) Aty ku kërkohet ndonjë vlerësim direkt i punës së mësuesit, ky vlerësim duhet të jetë objektiv dhe t'i bëhet i ditur mësuesit.

(2) Mësuesit duhet të kenë të drejtën e ankimit ndaj vlerësimeve që ata i konsiderojnë të pa justifikueshme.

65. Mësuesit duhet të jenë të lirë të përdorin teknika të atilla vlerësimi për nxitjen e progresit të nxënësve që ata i shohin të arsyeshme, por duhet të sigurohen që të mos ketë padrejtësi ndaj nxënësve të veçantë.

66. Autoritetet duhet t'u japin peshën e duhur rekomandimeve të mësuesve në lidhje me përshtatshmërinë e nxënësve të veçanatë për kurse dhe arsimim të mëtejshëm të llojeve të ndryshme.

67. Duhet bërë çdo përpjekje e mundëshme për të nxitur bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet prindërve dhe mësuesve në të mirë të nxënësve, por, gjithashtu, mësuesit duhet të mbrohen ndaj ndërhyrjeve të padrejta e të pa justifikueshme të prindërve në çështje të cilat janë në thelb përgjegjësi profesionale te mësuesit.

68. (1) Prindërve që kanë një ankesë ndaj një mësuesi apo shkolle duhet t'u jepet mundësia ta diskutojnë atë, në fillim, me titullarin e shkollës dhe me mësuesin në fjalë. Çdo ankesë që vijon dhe u adresohet autoriteteve më të larta duhet bërë me shkrim dhe mësuesi duhet të pajiset me një kopje.

(2) Shqyrtimet e ankesave duhet të kryhen në mënyrë të tillë që mësuesve t'u jepet një mundësi e drejtë për të mbrojtur vetveten dhe procedurat të mos publikohen.

69. Ndërsa mësuesit duhet të kenë kujdesin më të madh që të mos kenë aksidente me nxënësit, punëdhënësit e mësuesve duhet t'i mbrojnë ata nga rreziku i dënimeve ndaj tyre, kur dëmtimi apo aksidenti ndodh në rastin e aktiviteteve të shkollës, por larg apo jasht ambientit të shkollës.

Detyrat e mësuesit

70. Duke pranuar që statusi i profesionit të tyre varet në një masë të konsiderushme nga vetë mësuesit, të gjithë ata duhet të kërkojnë që të arrijnë standardet më të larta që është e mundur në të gjithë punën e tyre profesionale.

71. Standardet profesionale që lidhen me kryerjen e detyrës së mësuesit duhet të përcaktohen dhe të ruhen me kontributin e organizatave të mësuesve.

72. Mësuesit dhe organizatat e tyre duhet të kërkojnë që të koperojnë plotësisht me autoritet në interes të nxënësve, të shërbimit arsimor dhe të shoqërisë në përgjithësi.

73. Kodet e etikës apo të sjelljes duhet të përcaktohen nga organizatat e mësuesve, përderisa kode të tillë kontribuojnë shumë në sigurimin e prestigjit të profesionit dhe në ushtrimin e detyrave profesionale në përputhje me parime të pranuara.

74. Mësuesit duhet të jenë të përgatitur të marrin pjesë në aktivitete jashtë mrethit shkollor në të mirë të nxënësve dhe të moturve.

Mardhëniet ndërmjet mësuesve dhe shërbimit arsimor në përgjithësi

75. Në mënyrë që mësuesit të mund të shkarkohen nga detyrimet e tyre, autoritetet duhet të krijojnë dhe të përdorin rregullisht mjete të njohura konsultimi me organizatat e mësuesve për çështje të tilla si politikat arsimore, organizimi i shkollës dhe zhvillimet e reja në sistemin arsimor.

76. Autoritetet dhe mësuesit duhet të pranojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së mësuesve, nëpërmjet organizatave të tyre dhe me mënyra të tjera, në planet që përpilohen për përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor, në punën kërkimore arsimore dhe në zhvillimin e vlerësimin e metodave të reja të përmirësuara.

77. Autoritet duhet të lehtësojnë krijimin dhe punën e këshillave të formuara brenda një kohe apo një kuadri më të gjerë, për të nxitur koperimin e mësuesve të së njëjtës lënde dhe të marrin siç duhet në konsideratë opinionet dhe sugjerimet e këshillave të tilla.

78. Personeli administrativ dhe të tjerë që janë përgjegjës për aspekte të shërbimit arsimor duhet të përpiqen që të krijojnë mardhënie të mira me mësuesit dhe kjo pikpamje duhet të bazohet në reciprocitet të barabartë.

Të drejtat e mesuesit

79. Pjesëmarja e mësuesve në jetën publike dhe shoqërore duhet të inkurajohet në interes të zhvillimit personal të mësuesit, të shërbimit arsimor dhe të shoqërisë në përgjithësi.

80. Mësuesit duhet të jenë të lirë të ushtrojnë të gjitha të drejtat civile që gëzojnë në përgjithësi qytetarët dhe duhet të kenë të drejtën të hyjnë në zyrat e shërbimit publik.

81. Aty ku kërkesat për punë në sherbimin publik janë të tilla që mësuesi duhet të largohet nga detya e mësimdhënies, ai duhet të ruhet në profesion për kategoritë dhe qellime pensioni dhe duhet të jetë në gjendje të kthehet në pozitën e tij të mëparëshme ose në një punë të njëjtë, kur mandati i tij në zyrën e shërbimit publik të ketë mbaruar.

82. Si pagat ashtu edhe kushtet e punës të mësuesve duhet të përcaktohen me anë të negociatave ndërmjet organizatave të mësuesve dhe punëdhënësve të tyre.

83. Mekanizma statutore apo vullnetare duhen krijuar, të cilat të sigurojnë të drejtën e mësuesve për të negocuar, nëpërmjet organizatave të tyre, me punëdhënësit publik apo privat.

84. Mekanizma të përbashkëta të pershtateshme duhen krijuar që të meren me zgjidhjen e konflikteve qe lindin midis mësuesve dhe punëdhënsve në lidhje me kriteret dhe kushtet e punësimit. Nëse mjetet dhe procedurat e përcaktuara për këto qellime duhen ezauruar ose , nëse duhet të ketë një ndërprerje të negociatave midis palëve, organizatat e mësuesve duhet të kenë të drejtën për të marrë masa të tilla, të cilat janë të lejueshme edhe në organizatat e tjera në mbrojtje të interesave të tyre legjitime.

Nga aktivitetet e FSASH

FSASH dhe Seksionet ne rrethe perpara tri detyrave te rendesishme

Nga mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH

Ne mbledhjen e Keshillit Drejtues te Federates se Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, e cila u zhvillua ne Tirane me daten 9 shtator, u diskutua gjeresisht ne lidhje me disa nga detyrat kryesore te organeve qendrore te Federates dhe te seksioneve ne rrethe ne kuadrin e vitit te ri arsimor 2005-2006.

Ne fjalen hyrese qe paraqiti ne kete mbledhje Kryetari i Federates, zoti Xhafer Dobrushi, u evidentuan disa nga objektivat me te aferta e me te rendesishme me te cilat do te merren strukturat e FSASH ne qender e ne rrethe, tre me te kryesoret e te cilave jane: Miratimi i Vendimit te Qeverise per rritjen e pagave ne masen 15 perqind, duke filluar qe nga 15 shtatori, nenshkrimi i Kontrates Kolektive te Punes per nje periudhe tre vjecare ne vijim dhe hartimi e miratimi i Statusit te Mesuesit.

Detyra me e nguteshme, theksoi Zoti Dobrushi, mbetet miratimi i Vendimit te Qeverise per rritjen e pagave te mesuesve te sistemit parauniversitar, sipas Marreveshjes se nenshkruar me Qeverine e mepareshme ne muajin prill te ketij viti. Per te realizuar kete objektiv, FSASH duhet te ndermarre hapa te kujdesshem, duke filluar nga takimi me Ministrin e Arsimit dhe bisedimet per te zgjidhur problemin me mirekuptim, deri te ndermarrja e veprimeve sindikale, sipas kontrates kolektive dhe ligjeve ne fuqi. Por, u tha ne bledhje, per nje gje duhet te jemi te gjithe te vendosur: ne do ta mbrojme Marreveshjen qe kemi nenshkruar, sepse ajo erchi pas disa veprimve sindikale, te cilat paten mbeshtetje masive te anetareve tane e mesuesve ne teresi, gje qe mund te perseritet, ne rast se do te jete e nevojshme.

Ne lidhje me objektivin e dyte, per nenshkrimin e kontrates kolektive te punes, Zoti Dobrushi theksoi se, megjithese kontrata e fundit vazhdon te jete ne fuqi, sepse ajo nuk eshte denoncuar nga asnjera prej paleve, neve na duhet te angazhohemi, pa humbur kohe, per te filluar bisedimet, duke qene te pergatitur per kerkesat qe do te parashtrojme, mbeshtetur ne standardet nderkombetare te punes dhe ne praktiken e zbatimit te kontrates ekzistuese. Kjo do te jete nje pune shume serioze dhe do te kerkoje shume pune e perkushtim te te gjitha strukturave tona, e sidomos te Kryesise ne qender e te seksioneve ne rrethe, per te mbrojtur ato arritje qe tashme i kemi realizuar me kontraten ekzistuese, si edhe per te avancuar tregues te vecante qe kane te bejne, sidomos, me lirite e te drejtat sindikale.



Ne lidhje me objektivin e trete, per hartimin dhe miratimin e Statusit te Mesuesit, ai theksoi se disa masa pergatitore jane marre me stafin e meparshem te Ministrise, por me sa duket, kete pune do te na duhet ta fillojme nga e para. Ne jemi te pergatitur per kete ceshtje, kemi konsultuar materialet perkatese, perfshire edhe Rekomandimet e ILO-UNESKO per Statusin e Mesuesit, te cilat, edhe pse te miratuara shume vjet me pare, mbeten shume aktuale, persa u perket te drejtave e detyrave te mesuesve dhe mardhenieve me punedhenesin.

Ne pefundim, Zoti Xhafer Dobrushi foli mbi disa nga drejtimet kryesore te punes per forcimin organizativ te strukturave te Federates ne qender e ne rrethe dhe per domosdoshmerine e bashkepunimit me Sindikaten e Pavarur te Arsimit Shqiptar, ne favor te mbrojtjes se interesave te mesuesve e pedagogeve.

Duke e marre fjalen ne mbledhje, drejtuesit e seksioneve sindikale te disa rretheve, anetare te Keshillit Drejtues te Federates, u ndalen tek disa nga detyrat aktuale, si edhe problemet e veshtiresite me te cilat ata po ballafaqohen ne rrethe e ne baze.

Kryetari i Seksionit sindikal te Mallakastres, zoti Neim Hajderaj, theksoi se situaten e kemi te mire dhe do te vazhdojme ta permiresojme, por, per kete, na duhet te punojme me shume,

ne te gjitha nivelet. Ne baze, theksoi ai, ka nevoje per diskutime e soparime, sidomos ne lidhje me tre objektivat per te cilat po diskutojme ne kete mbledhje, prandaj, na duhet te organizojme disa takime zonale, me pjesemarrjen e drejtuesve te seksioneve e kryetareve te shkollave, me synim qe te sigurojme nje angazhim me te mire te tyre per keto probleme e objektiva.

Kryetarja e Seksionit sindikal te rrethit te Fierit, zonja Niketa Gokaj, insistoi qe te kerkojme te realisojme me cdo kusht ate qe u kemi premtuar anetareve tane dhe mesueve ne teresi, per rritjen e pagave 15 perqind, duke filluar nga 1 shtatori 2005.

Ne vijim, Kryetari i Seksionit te Tiranes Rreth, zoti Berti Çaprazi, theksoi se eshte shume e rendesishme qe ne te kemi nje bashkepunim normal me SPASH, ne lidhje me te treja keto probleme, per te cilat po diskutojme ne kete mbledhje, sepse keshtu do te jemi me rezultative.

Kryetari i Seksionit sindikal te Elbasanit, zoti Osman Nika, theksoi se punen tone duhet ta shikojme ne menyre kritike. Ne kete fryme, duhet te pranojme qe duhej te kishim insistuar qe vendimi per pagat te ishte miratuar nga qeveria e mepareshme, jo shume vone pas Marreveshjes. Tani na duhet te kembengulim shume per kete vendim, sepse, ne nje fare mase, kjo ka te beje edhe me anetaresine ne sindikaten tone. Per kete, ne duhet te shfrytezojme me mire edhe bisedimet per kontraten kolektive.

Zoti Shaqir Angoni, kryetar i Seksionit sindikal te Gjirokastres, theksoi se, pas takimit qe u organizua ne seksionin e ketij rrethi ne muajin maj, ne jemi duke punuar per te bere ndryshime rrenjesore te gjendjes. Realizimi i objektivave per te cilat po diskutojme ne kete mbledhje, theksoi ai, do te kishte nje ndikim te fuqishem edhe per punen tone ne keto drejtime.

Probleme te kesaj natyre dhe çeshtje qe kane te bejne, sidomos, me Kontraten Kolektive dhe Statusin e Mesuesit, ngriten ne diskutimet e tyre edhe zv/kryetaret e Federates Petref Çelaj e Fatbardha Keço, si edhe Kryetarja e Seksionit te Librazhdit, Zela Koka, Kryetari i Seksionit te Dibres, Selami Kaza, Kryetari i Seksionit te Kuksit, Isuf Cahani, kryetari i seksionit te Mirditës Xhovalin Gjinaj etj.

Sekretari i Pergjithshem i Federates, zoti Stavri Liko, shtroi disa detyra qe kane te bejne me angazhimin e seksioneve sindikale ne rrethe per realizimin e objektivave qe FSASH ka ne kuadrin e projekteve me AOB dhe ILO-IPEC, sidomos per punen me grate dhe mesuesit e rinj, si edhe per nje angazhim me te mire te mesuesve per eliminimin e punes se femijeve.

Keshilli ngarkoi Kryesine e Federates qe te ndjeke me pergjegjesi zbatimin e vendimeve te kesaj mbledhjeje dhe te informoje seksionet sindikale ne rrethe per veprimet e metejshme.

Prononcim i Seksionit Sindikal te FSASH per rrethin e Elbasanit

Me rastin e fillimit te vitit te ri shkollor

Me rastin e fillimit te vitit te ri shkollor, nepermjet nje Deklarate per Shtyp, Kryesia e Seksionit Sindikal te FSASH per rrethin e Elbasanit, uron gjithe mesuesit, pedagoget, nxenesit e studentet, si dhe punonjesit e arsimit ne teresi, per nje vit shkollor te mbare e te suksesshem per realizimin e objektivave per modernizimin e sistemit arsimor, per nje arsim cilesor per te gjithe dhe per nje edukim qytetar te nxenesve e studenteve. Me kete rast, Kryesia e FSASH per rrethin e Elbasanit pohon se do te vazhdoje te qendroje ne krah te mbrojtjes se interesave ekonomike te mesuesve, te permiresimit te kushteve te punes e te mesimit per mesuesit e nxenesit, duke bere kujdes qe qendrimet e veprimet e saj per mbrojtjen e ketyre interesave te jene ne peputhje te plote me legjislacionin ne fuqi, me konventat nderkombetare dhe me Kontraten Kolektive te Punes.

Nepermjet mesuesve me pervoje, theksohet ne Deklarate, ne do te japim kontributin tone real e konkret ne procesin e reformimit te sistemit arsimor, ne perputhje me strategjine kombetare te zhvillimit te arsimit ne vendin tone.

Ne kete rruge, sindikata jone do te insistoje ne rruge logjike, ligjore e demokratike per realizimin e Marreveshjes me Qeverine per rritjen e pagave te mesuesve me 15 perqind, duke filluar qe nga 1 shtatori, per nenshkrimin e Kontrates Kolektive te Punes te nivelit te pare e te dyte, si edhe per miratimin e Statusit te Mesuesit.

Funksionimi institucional, ligjor e kontraktual arrihet kur edhe strukturat e sindikates sone jane te tilla, prandaj seksioni do te beje kujdes per konsolidimin e strukturave ne rreth e ne shkolla, duke u bere te qarte mesuesve se mbrojtja ligjore do te jete per anetaret qe paguajne kuotizacionin e anetaresise dhe qe jane aktive ne mbrojtje te interesave te tyre.

Rritja e numrit te grave dhe mesuesve te rinj ne sindikate do te ndikoje se tepermi ne fuqizimin e metejshem te saj dhe rritjen e efektivitetit te punes se strukturave te saj ne te gjitha nivelet.

Seksioni sindikal i FSASH Elbasan do te vazhdoje te punoje ne bashkepunim me seksionin e SPASH ne kete rreth, sepse te perbashketa jane interesat e mesuesve dhe te punonjesve te arsimit ne pergjithesi.

Pjesemarrja ne projekte te perbashketa, sic jane ato per uljen e numrit te nxenesve qe braktisin shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve, do te ndikoje per forcimin e ketij bashkepunimi dhe arritjen e rezultateve me te mira edhe ne keto drejtime, perfundon Deklarata e Seksionit Sindikal te rrethit te Elbasanit.

Eliminimi i punes se femijeve, çeshtje e rendesishme, jo vetem per sindikatat e arsimit

Nga zbatimi i Programit te FSASH me IPEC

Ne vazhdim te angazhimeve te saj per rritjen e rolit te mesuesve, anetareve dhe drejtuesve sindikaliste per luften kunder punes se femijeve, FSASH, ne bashkepunim me Zyren ILO-IPEC ne Tirane, ka fillur punen per zbatimin e nje programi veprimi mbi rritjen e kapaciteteve te sindikates shqipare te arsimit, FSASH, ne luften kunder punes se femijeve. Programi do te zbatohet per nje periudhe pese mujore dhe perfshin disa aktivitete te cilat pritet qe te



kene nje ndikim te drejtperdrejte, jo vetem tek drejtuesit dhe aktivistet e sindikatave te arsimit, por edhe tek ata te degeve te tjera. Programi perfshin perkthimin, pershtatjen dhe botimin ne shqip te nje libri me permbajtje shume interesante te titulluar "Sindikatat dhe puna e femijeve". Libri perbehet nga shtate broshura, te cilat trajtojne çeshtje te veçanta qe kane te bejne me angazhimin e sindikatave per eliminimin e punes se femijeve.

Broshura e pare shpjegon permbajtjen e seciles prej broshurave, jep udhezime mbi menyren e perdorimi te tyre ne punen dhe jeten e perditeshme, ne seminaret interaktive dhe ne rrethet studimore, si edhe jep nje liste te botimeve te ndryshme dhe te materialeve qe mund te gjenden ne zyrat e IPEC, ne lidhje me punen e femijeve.

Broshura e dyte e titulluar "Politikat sindikale dhe planet e veprimit për të luftuar punën e fëmijëve", bën shpjegimin e punës së fëmijëve, si një çështje sindikale, jep një kuadër të veprimeve sindikale per kete ceshtje, ndihmon për hartimin e politikave sindikale, mbështet procesin e përcaktimit të prioriteteve dhe hartimit të planeve të veprimit.

Broshura e trete, e cila titullohet "Gjetja e fakteve dhe informacioni mbi punën e fëmijëve", jep informacion në lidhje me vendin ku mund të gjenden fakte interesante mbi punën e fëmijëve, tregon metodat që mund të përdorin sindikatat për të plotësuar të dhënat e veta, jep udhëzime mbi informacionet e nevojshme për veprimet sindikale.

Broshura e katert, qe titullohet "Organizimi i fushatave kundër punës së fëmijëve", jep informacion mbi çështjet e organizimit të Fushatave dhe të veprimeve sindikale të niveleve të ndryshme, dhe jep udhëzime mbi organizimin e Fushatave të suksesshme.

Broshura e peste, e cila titullohet "Kontratat kolektive për të luftuar punën e fëmijëve", shpjegon se si sindikatat mund të përdorin kontratat kolektive për të luftuar punën e fëmijëve, siguron që sindikatat të kuptojnë nivelet e ndryshme të aktiviteteve sindikale, siguron që sindikatat të kenë mjetet e nevojshme për të ndërmarrë veprime në fushën e kontratave kolektive dhe jep informacion mbi iniciativa të tjera ndërkombëtare.

Broshura e gjashte, qe titullohet "Përdorimi i standardeve të ILO për të luftuar punën e fëmijëve", ben një prezantim të standardeve ndërkombëtare të punës, sidomos të standardeve themelore, jep udhëzime specifike për përdorimin e dy konventave kryesore të ILO për punën e fëmijëve dhe paraqet instrumentet e tjera ndërkombëtare që mund të ndihmojnë në luftën kundër punës së fëmijëve.

Broshura e shtate, qe titullohet "Strukturat tripalëshe për të luftuar punën e fëmijëve", shpjegon kuptimin e rolit të partnerëve socialë në luftën kundër punës së fëmijëve, eksploron çështjen e krijimit të aleancave dhe rrjeteve me grupet e tjera të përfshira në luftën kundër punës së fëmijëve, informon në lidhje me departamentet përkatëse të ILO dhe aktivitetet e tyre për të luftuar punën e fëmijëve.

Libri permbledh, gjithashtu, pervoje nga shume organizata sindikale nderkombetare, jep informacione mbi partneret sociale, organizatat joqeveritare etj.

Nje Tavoline e Rrumbullakte do te organizohet per te diskutuar ne lidhje me permbajtjen e librit dhe per pasqyrimin e pervojes e te problemeve qe ne kemi ne vendin tone, si edhe ne lidhje me disa te dhena mbi verimtarine e IPEC ne Shqiperi. Perqendrimi ne tre rrethe, Korçe, Elbasan dhe Berat, per nje pune me konkrete, do ta beje Programin me efektive dhe do t'i jap atij me shume mundesi per te patur rezultate konkrete, sidomos ne shmangien e braktisjeve nga shkolla. Seminaret qe do te organizohen ne keto rrethe do te paraprihen nga nje pune pararake dhe do te shoqerohen me aktivitete te tjera, ne vijim te ketij programi. Kjo do te ndihmoje edhe per nje pune ne vazhdimesi, pas perfundimit te programit.Programi do te shoqerohet me nje publicitet per aktvitetet qe do te organizohen, nepermjet tre emisioneve televizive qe do te pergatiten dhe trasmetohen ne ditet e zhvillimit te seminareve ne keto rrethe. Po keshtu do te botohet edhe nje numer i veçante i Revistes "Tribuna Sindikale", i cili do te perfshije nje permbledhje te materialeve te pergatitua ne kuadrin e ketij Programi dhe nje permbledhje te aktiviteteve te organizuara ose qe priten te orgnizohen ne te ardhmen ne kete kuader.

Nga aktivitetet e SPASH

Vazhdon Fushata e zgjedhjeve ne SPASH

Ne fillim te nentorit mblidhet Kongresi i SPASH

Pas perfundimit te analizave e zgjedhjeve ne shkolla, Fushata per zgjedhjet e reja ne Sindikaten e Pavarur te Arsimit Shqiptar, SPASH, po vazhdon ne nivelet me te larta te strukturave te saj ne rrethe.

Jane zhvilluar konferencat e seksioneve sindikale te disa rretheve dhe jane ne pergatitjet e fundit per t'i zhvilluar ato shumica dermuese e rretheve te tjera, me synimin per t'i mbaruar perpara 25 tetorit, per te mbledhur Keshillin Kombetar me daten 28 tetor dhe Kongresin ne ditet e para te nentorit.

Fushata po ndiqet me interesim te vecante nga mesuesit anetare te SPASH, nga strukturat e saj drejtuese, si edhe nga mjafte mesues te tjere ne shkolla e ne seksionet sindikale te rretheve.

Konferencat e seksioneve sindikale te rretheve Gjirokaster, Diber, Fier, Puke, Delvine etj, jane zhvilluar me debate e konkluzione dhe kane percaktuar detyra te rendesishme per te ardhmen. Kerkesat ekonomike, sidomos ato qe kane te bejne me rritjen e pagave, nevoja per nje vleresim me te mire te figures se mesuesit, kerkesa per nje zbatim me korrekt te Kontrates Kolektive te Punes etj, kane qene nder temat me te rendesishme qe jane diskutuar ne keto konferenca.

Ne analizat qe jane bere ne shkolla dhe ne konferencat qe jane zhvilluar ne seksionet e rretheve jane bere verejtje per shkeljen e neneve te Kontrates Kolektive Kolektive te Punes qe kane te bejne me levizjet dhe emerimet e mesuesve, gje qe duhet te marre fund ne te ardhmen.

Objekt i rendesishem i Fushates se zgjedhjeve ne SPASH kane qene, gjithashtu, tre objektivat me te rendesishme te sindikatave te arsimit, per periudhen ne vijim, sic jane ato te rritjes se pagave, negocimet dhe nenshkrimi i Kontrates se re Kolektive te Punes dhe miratimi i Statusit te Mesuesit.

Keto ceshtje dhe te tjera probleme qe kane dale e pritet te dalin ne Konferencat e rretheve qe do te zhvillohen keto dite e ne vazhdim do te jene objekt diksutimi edhe ne mbledhjen e ardheshme te Keshillit Kombetar te SPASH, e cila do te diskutoje e vendose, gjithashtu, edhe per materialet qe do t'i paraqiten Kongresit, si edhe per procedurat dhe kandidaturat e organeve drejtuese te SPASH.

DËFRIM SPAHIU
Sekretar i Përgjithshëm i SPASH

Pervoje qe duhet njohur e zbatuar

FEDERATA E MESUSEVE TE PENSILVANISE

Çdo sindikate, sidomos ne sektorin e arsimit, ka pese funksione dhe pergjegjesi kryesore perpara antareve te saj.

1 Sindikata duhet te perfaqsoje interesat kolektive (te perbashketa) te anetareve. Kjo

arrihet permes marreveshjeve kolektive me punedhenesit dhe duke e zbatuar marreveshjen qe nga koha kur ajo hyn ne fuqi. Anetaret e sindikates, qe jane te punesuar kolektivisht, e kane mbeshtetur sindikaten, ne rradhe te pare, per kete arsye kryesore.

2 Sindikata e ka per detyre te perfaqsoje anetaret individuale (ose grupe anetaresh)

sidomos ne nje situate kur personi ndesh veshtersi personale gjate kryerjes se detyres se tij ne pune. Ky lloj perfaqsimi natyrisht perfshin ankesat qe mund te dalin, por sindikata gjithashtu ka pergjegjesi te siguroje perfaqsim juridikose te ndihmoje anetare individual ne situata ku ata gjenden , ose te merret me problemet qe kane te bejne me te gjithe anetaret. Vetem fuqia kolektive e sindikates mund te siguroj fondet, mundesite dhe eksperiencen e nevojshme, qe bejne te mundur kete lloj perfaqsimi ne raste ankesash dhe perfaqsim me te gjere legal (mbrojtje legale).

3 Çdo sindikate por sidomos sindikatat e sektorit publik, si Federata e Mesueseve ka

nje pergjegjesi me te madhe qe te luaj rol aktiv ne arenen politike.(Kjo nuk do te thote qe sindikata te dale me kandidatet e vet per poste publike. Vete sindikata nuk duhet te behet nje arene politike ose te ngaterrohet me politiken kombetare ose lokale. Por interesat e anetareve te sindikates dhe te arsimit shpesh percaktohen nga institucionet politike dhe politikanet). Eshte e qarte qe nese persona kunder arsimit publik mbajne poste kombetare, shteterore apo lokale, atehere interesat e arsimit publik vetem mund te demtohen. Federata jone ka qene aktive ne te gjitha nivelet politike, dhe ne kemi pasur disa arritje te dukshme ne kete drejtim.

4 a) Sindikatat duhet te ndajne pergjegjesin per suksesin e ndermarrjes ose institucionit ne te cilen anetaret jane punesuar .Sindikata nuk mund t'ia besoje mireqenien e ndermarrjes ku punesohen anetaret e saj vetem kontrollit te administrates se nese per shembull, sistemi yne shkollor dhe arsimi publike deshtojne ose bien ne cilesi, atehere mireqenia e anetareve pa dyshim qe vihet ne rrezik. Arsimi publik duhet te kete sukses nepofte se dhet t'i sherbejme mire anetareve tane.

b) Gjithashtu me me rendesi ne kemi pergjegjesin shtese qe te sigurohemi

qe arsimi publik te forcohet, sepse arsimi publik i sherben te gjithe familjeve te kombit. Ne te vertete, nje sistem arsimi publik efektiv dhe i realizushem forcon traditen demokratike qe i ka sherbyer shume mire kombit tone.

c) Se fundi, brenda kategorise se katert te pergjegjesive te sindikates bie e gjithe fusha e zhvillimit dhe ruajtjes se nje roli profesional dhe klime te vertete profesionale per mesuesit brenda shkollave, krijimin e nje " profesioni te vertete arsimor".

Vijon në faqen 12

FEDERATA E MESUSEVE TE PENSILVANISE

Vijon nga faqja 11

5) a) Funksioni dhe detyra e fundit e sindikates ndaj anetareve te saj

eshte qe vete sindikata duhet te administrohet me efektivitete, ne menyre demokratike dhe me ndershmeri. Asnje sindikate nuk mund t'i sherbeje mire anetareve ne qofte se vete sindikata eshte e paorganizuar dhe nuk vepron ne menyre te planifikuar, pa financim te kujdesshem dhe pa mbajtur pergjegjesi para aetareve.

b) Gjithashtu interesat e politikes se brendeshme te sindikates nuk te motivojne veprimet (ose mungesen e veprimtarise) nga ana e sindikates . Nje sindikate e percare politikisht zakonisht eshte e paefekteshme .

c) Sindikata duhet qe vazhdimisht te rigjalleroje antaresine dhe te rekrutoj antare te rinj. Sindikata duhet te mbaje komunikim te vazhdushem te qarte, te sakte dhe ne kohen e duhur me anetaret. Sindikata duhet te ruaje fuqine e brendshme dhe financiare, perndryshe nuk mund te realizoje rolin dhe detyrat qe i ka caktuar anetaresia dhe qe priten prej saj.

Do te ishte mire qe keto pese pergjegjesi dhe funksione te gjera te sindikates te mbahen parasysh kur analizojme organizatat lokale, shteterore dhe kombetare.

Kuatat qe paguhen nga anetaret jane nje investim i fuqishem dhe i nevojshem kur keto pese fusha pergjegjesie permbushen me konsistence nga lokalet.

d) Se fundi, te gjithe ne qe perbejme mbeshtetjen e cdo sindikate dhe ata anetare qe mbajne pozita udheheqese ne sindikate ose detyra te tjera sindikale duhet te jemi te sigurte qe levizja sindikale, ne te cilen ne te gjithe kemi besim te madh, do te zhvillohet dhe do te forcohet per sa kohe qe ne mbajme parasysh vazhdimisht dhe qartesisht keto pese objektiva.

Fushat e veprimit të sindikatave per eliminimin e punes se femijeve

Gjetja e Fakteve, Vëzhgimi dhe Informacioni

Gjetja e fakteve, lidhur me punën e fëmijëve, dhe përcaktimi i veçorive të problemit të punës së fëmijëve, janë mjete të domosdoshme për të hartuar një program, për të vendosur mbi prioritetet, për të zhvilluar strategjitë dhe për të gjetur zgjidhje për raste të veçanta të punës së fëmijëve. Sindikatat



duhet të kryejnë vëzhgime dhe të sigurojnë dokumentacionin e rasteve konkrete të punës së fëmijëve, në mënyrë që të jenë në gjendje të marrin masa efikase kundër këtij fenomeni.

Rritja e Ndërgjegjsimit, Mobilizimi dhe Fushatat

Rritja e ndërgjegjsimit dhe mobilizimi janë mjete të rëndësishme për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve. Shumë ndër punët e ILO në 10-vjeçarin e fundit kanë bërë që të rritet ndërgjegjsimi në lidhje më këtë çështje. Shumë sindikata, kur janë përfshirë për herë të parë në çështjen e punës së fëmijëve, kanë filluar duke i bërë anëtarët e tyre më të ndërgjegjshëm lidhur me këtë problem. Puna e fëmijëve duhet të bëhet e papranueshme në sytë e opinionit publik e të të gjithë niveleve të shoqërisë. Materiale të shumta publicitare janë venë në dispozicion nga ILO për këtë qëllim. Ato mund të gjenden në qendrat e vendeve përkatëse ose pranë organizatave sindikale ndërkombëtare.

Negocimet Kolektive

Sindikatat mund të zhvillojnë bisedime me punëdhënës në nivele të ndryshme për mbështetje, riaftësim ose masa të tjera, në mënyrë që të eliminojnë punën e fëmijëve. Me këtë, synim, ato mund të firmosin marrëveshje me punëdhënësit, mbi hapat që duhen ndërmarrë në procesin e eliminimit të punës së fëmijëve. Marrëveshje të tilla duhet të zbatohen detyrimisht nga të dyja palët.

Përdorimi i Standardeve Ndërkombëtare të Punës

Konventa e re e ILO Nr. 182, mbi Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve është një armë për sindikatat në luftën kundër punës së fëmijëve. Një ndër objektivat e kësaj fushate është ratifikimi i menjëhershëm i kësaj Konvente nga ana e qeverive. Nëse vendi juaj nuk e ka ratifikuar akoma Konventën Nr. 138 të ILO, mbi Moshën Minimale të Punësimit, e cila është instrumenti bazë për mënjanimin e punës së fëmijëve, atëherë sindikatat duhet të punojnë që edhe kjo Konventë të ratifikohet sa më shpejtë.

Sindikatat duhet të nxisin dhe të përdor-

in komitetet ekzistuese tripalëshe, për t'u konsultuar dhe për të argumentuar domososhmërinë e ratifikimit të këtyre dy Konventave të ILO, Nr. 138 dhe 182, nga ana e qeverive.

Përdorimi i Strukturave Tripalëshe për Përmirësimin dhe Zbatimin e Legjislacionit

Në shumë vende ekziston një legjislacion që merret me punën e fëmijëve, por shpesh ai nuk zbatohet siç duhet. Zbatimi i ligjit ka nevojë të përforcohet, nëpërmjet trajnimit të personelit përkatës, përfshirë edhe inspektorët e punës. Aty ku legjislacioni nuk ekziston, sindikatat mund të ushtrojnë presion mbi qeveritë, në mënyrë që të miratohen ligje të reja. Nëse ligjet janë të vjetëruara, sindikatat mund të nxisin rishikimin e tyre. Në të dyja rastet, sindikatat duhet të zhvillojnë një politikë të qartë mbi përmbajtjen e ligjeve të punës së fëmijëve dhe të hartojnë një plan për të ndërmarrë veprime, mbi bazën e legjislacionit kombëtar. Sigurisht që legjislacioni duhet të ndjekë standardet e vendosura në konventat e ILO.

Sindikatat mund të zhvillojnë Fushata, në mënyrë që qeveritë të vendosin për një buxhet të përshtatshëm për inspektoriatet e punës, në përputhje me Konventën e ILO Nr.81, mbi Inspektoriatin e Punës. Sindikatat duhet, gjithashu, të bëjnë presion për të patur një mbikqyrje tripalëshe të inspektoriateve të punës.

Veprimet Kundër Punës së Fëmijëve Nëpërmjet Arsimimit

Marrja e masave për arsimimin është një mënyrë efikase për të ndaluar shumë forma të punës së fëmijëve. Përveç vënies në dispozicion të shkollave, arsimi 9 vjeçar duhet të jetë i detyrueshme dhe duhet hartuar një sistem i përshtatshëm për të monitoruar e forcuar vazhdimin e shkollës. Sindikatat mund të punojnë me organizatat e mësuesve për të nxitur cilësinë, arsimimin bazë, i cili duhet të jetë falas, si një mjet për të paranda luar punën e fëmijëve. Kur sindikatat, në një farë mënyre, e kanë përfshirë arsimimin në programet e tyre të veprimit, kjo nuk është bërë për të marrë përsipër përgjegjësitë e qeverisë, por për të treguar se është e mundur të sigurohen kushtet për arsimim dhe të përdoret çështja e arsimimit për të mobilizuar komunitetin.

Riaftësimi Nëpërmjet Sigurimit të Shërbimeve Mbështetse

Thjesht të heqësh fëmijët nga vendi i punës, nuk është e mjaftueshme. Pa pasur alternativa të tjera, fëmijët mund të gjejnë punë edhe më të rrezikshme. Lënia e punës duhet të shoqërohet me riafësimin. Disa fëmijë mund të jenë në gjendje të integrohen në sistemin e shkollës, të tjerë mund të kenë nevojë për qendra të specializuara për të plotësuar nevojat e tyre, që përfshijnë strehimin, shërbimet mjekësore e ushqimore, trajnime profesionale, aktivitete për t'u shlodhur dhe këshillime intensive. Disa sindikata janë përfshirë vet direkt në sigurimin e këtyre shërbimeve. Kjo është një zgjidhje për një periudhë të shkurtër kohe, sepse kryerja e shërbimeve të tilla duhet të jetë detyrë e shtetit ose agjensive të mëdha të vullnetarëve, me eksperiencë të përshtatshme e me burime të konsiderueshme. Sindikatat duhet të organizojnë Fushata për të siguruar burimet e nevojshme për këtë lloj aktiviteti nga ana e qeverive.

Mbështetja për Mundësitë e Gjenerimit të të Ardhurave për Familjet

Shumë fëmijë janë të detyruar të punojnë për të shtuar të ardhurat e familjes. Si rregull, në shumë raste, heqja e fëmijëve nga punët me kohë të plotë ose të pjesshme, duhet të kombinohet me mundësi alternative sigurimi të ardhurash për familjet e tyre. Sindikatat mund të punojnë me grupe të tjera, në mënyrë që të zhvillojnë skema për sigurimin e të ardhurave në dobi të atyre familjeve që i kanë humbur ato për shkak të fëmijëve që nuk po punojnë më. Inkurajimi dhe mbështetja e këtij lloji aktiviteti është një mënyrë nëpërmjet të cilës sindikatat mund të japin mbështetje direkte në mbrojtje të fëmijëve që punojnë.

Rifillon "beteja" për diturinë...

(Në shkollën 9-vjeçare "Naim Frashëri", Tiranë)

1.

U ndodhëm në mjediset e shkollës 9-vjeçare të qytetit Tiranë, pak ditë para se të niste viti i ri arsimor 2005-2006. Ajo ndodhet në një lagje të qetë, në të djathtë të Rrugës së Kavajës. Siç është bërë tradite, por dhe kërkesë e domosdoshme, kishte kohë që aty gjallonin oborri, klasat e korridoret. U bënë regjistrimet e nxënësve dhe kujdes iu kushtua sidomos atyre të kater klasave të para. Të interesuar për t'i nisur sa më mbarë mësimet, dhanë ndihmesën e tyre mësues e nxënës, prindër e banorë të tjerë të komunitetit. Përveç lyerjeve e pastrimeve të nevojshme, u rregulluan e u pasuruan stendat, klasat e kabinetet mësimore. U tërhoqën të gjitha tekstet mësimore, që ishin botuar dhe do t'iu shpërndaheshin nxënësve në ditën e parë të shkollës. Mësuesit përgatisnin me kujdes dokumentet e nevojshme, sipas Udhëzimit të MASH. Në krye të të gjitha punëve të kolektivit arsimor gjetëm drejtorin Bardhosh Selami, zv.drejtorët Shkëlqim Gjonçaj, Keti Afezolli e Adem Kapllani.

Dhe ja, përsëri shkuam ndërmjet kolektivit të kësaj shkolle në ditën e parë të mësimeve, në mënggjesin e datës 19 shtator. Oborri gumëzhinte si koshere bletësh. (Sa bukur do të ishte sikur aty të ngrihej dhe një bust i Naim Frashërit! Por...mungesa e një fondi financiar është bërë pengesë?!) Qindra nxënës, me mesuesit dhe prindërit e tyre, i gëzoheshin kësaj feste të përbashkët, kur përsëri ata do të nisnin udhën e dijes, por tashmë një vit më të rritur dhe një klasë më lart. Kënaqësinë e tyre dhe ndërimin ndaj mësuesve, nxënësit e shprehnin me buqetat e luleve të freskëta ndër duar, me buzëqeshjen e çiltër të moshës së tyre. Sigurisht, më të lumturuarit ishin vogëlushët e klasave të para.

Në atë tubim festiv, të gjithë u njohën me përshëndetjen e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, z. Genc Pollo, dëgjuan fjalën e drejtorit të shkollës etj. Mendimi i tyre i përmbledhur ishte: Sivjet do të shënohen tregues më të lartë në procesin mësimor-edukativ, në shkollë e jashtë saj.

Pastaj grupe-grupe, të gjithë nxënësit me mësuesit e tyre, u drejtuan nëpër klasa. Pas pushimeve të gjata të verës, mbushur plot emocione e mbresa të shumta, ata përsëri rifilluan "betejën" për dijen. Mësimi nisi rregullisht, me libra e fletore. Këtë e pamë në në klasën e 5-A me mësuese Violeta Vrapin, në kl.7-C me Ludmilla Isaiaj, në kl.5-F me Irma Bejkon, në kl.5-C me Pëllumbesha Alimehmetin etj. Tavolinat e tyre ishin mbushur me lule të freskëta, që nxënësit e tyre ua kishin sjellë në shenjë dashurie e mirënjohjeje.

Vijon në faqen 14

Rifillon "beteja" për diturinë...

Vijon nga faqja 13

2

Kjo shkollë 9-vjeçare, që mban emrin e poetit e atdhetarit të madh të Rilindjes sonë Kombëtare, Naim Frashëri, është ndër më të njohurat në kryeqytet. Kjo mund të thuhet jo vetëm për numrin e madh të nxënësve, që vijojnë në të, afër 1.600 dhe të 55 mësuesve që u japin atyre edukatë e njohuri në fusha të ndryshme të dijes, por edhe për arritjet gjithnjë e më të kënaqshme në procesin mësimor-edukativ. Të gjithë së bashku, mësues, nxënës e prindër përpiqen të plotësojnë sa më mirë kërkesat e një shkolle cilësore.

"Vitin e kaluar arsimor arritëm tregues të lavdërueshëm, -tregon drejtor Selami.-Kalueshmëria ishte 99.7% dhe nota mesatare 7.5. Domethënëse është se pothuajse të gjithë nxënësit, që mbaruan 100 % klasat e teta tek ne, sivjet janë regjistruar në shkollat e mesme të kryeqytetit. Ndër "sekretet" e sukseseve tona përmendim se është bërë e mundur që numri i nxënësve në klasa të mos jetë i lartë, pra 32 në CU dhe 35 në CL, me synimin që ta ulim më tej. Në procesin mësimor-edukativ janë tërhequr të gjithë nxënësit, që i përfshin detyrimi shkollor në lagjen tonë dhe, kryesorja, kemi kënaqësinë të pohojmë se braktisja është në shifrën zero. Përveç punës së kujdesshme të mësuesve në shkollë, kemi mundur të sigurojmë bashkëpunim të frytshëm me prindërit dhe gjithë komunitetin".

Por ka dhe arsye të tjera se përse punët në këtë shkollë kanë ecur mirë dhe pritet që sivjet të shënohen tregues më të lartë cilësorë. Kështu, është bërë menaxhimi i mirë i burimeve njerëzore dhe është siguruar harminizim i veprimeve, në staf e në kolektiv. Klasat e kabinetet janë kthyer në mjedise mësimi e debati, pune e veprimtarish. Me planifikim të rregullt po ecet sipas strategjisë arsimore, që është hartuar për vitet e ardhëshme. Është bërë mjaft punë për zbatimin e standardeve bashkëkohore dhe njohjen e strukturës së re të arsimit të detyruar 9-vjeçar, por dhe më tej të arsimit të mesëm. Të gjitha këto janë pasqyruar në planet e drejtorisë dhe në ato të departamenteve lëndore etj. Me kujdes është vëzhguar dhe përgjithësuar përvoja e përparuar. Ndihmesë të mirë ka dhënë botimi periodik i gazetës së shkollës, me emrin simbolik "E ardhmja".

Tanimë këtu të flasin dhe për punën e lavdërueshme të



mësuesve: gjuhës e letërsisë Jolanda Çollaku, matematikës Lumturi Gjoni, anglishtes Vali Troja, ciklit të ulët Venetike Dervishi e të tjerë.

Kjo shkollë është kthyer dhe në një qendër komunitare, e cila çdo ditë gumëzhin nga veprimtaritë e larmishme. Për arritjen e këtij qëllimi janë përfshirë drejtoria, bordi i shkollës, komiteti i prindërve, qeveria e nxënësve etj. Një ndihmë të pakursyer ka dhënë sigurimi i lidhjeve e i bashkëpunimit me fondacione e organizata të ndryshme shoqërore. Kjo ka bërë të mundur që të vihen në jetë miniprojektet e hartuara, sidomos në fushën e edukimit dhe zhvillimit të veprimtarive kulturore e sportive. Ndër veprimtaritë mbresëlënëse ka qenë dhe ajo për njohjen e gatimeve nga krahina të ndryshme të vendit tonë. Po kështu, me ndihmën e Fondacionit zviceran ISF, është arritur që të ndahen dhurata për nxënës e mësues. Tregues i rëndësishëm është se nxënësit përfaqësues të kësaj shkolle kanë zënë vende të merituara në olimpiada e konkurse të ndryshme rajonale e kombëtare. Kështu, vetëm në krijimtari letrare dhe në pikturë ata kanë fituar 8 çmime. Kujdesi për integrimin e nxënësve në nevojë ka qenë pjesë e rëndësishme e këtyre miniprojekteve. Ndër të tjerat, është bërë e mundur që të sigurohen karroca për nxënës me probleme shëndetësore dhe sivjet do të punohet që, me ndihmën e një fondacioni italian, të ngrihet një menzë.

Por tërë gjallërimit të jetës e veprimtarive në këtë shkollë i kanë shërbyer edhe lidhjet e binjakëzimet me shkollat shqipe në Kosovë e në Maqedoni. Me nxënës e mësues janë organizuar vizita të bukura në qytetet Prishtinë, Prizren, Gjakovë etj. Por dhe që andej kanë ardhur këtu mysafirë e janë pritur me dashuri vëllazërore nxënës e mësues kosovarë.

Kur flasim për arritjet në edukim, në mësim dhe në veprimtaritë e ndryshme në këtë shkollë, meriton të përmendet puna e bashkëpunimi i ndërsjelltë i drejtorisë me organizatën sindikale. Veprimtarët e saj marrin pjesë aktive në të gjitha diskutimet dhe vendimet e ndryshme, që merren për mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ, për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme. Në këtë drejtim kanë qenë me fryt mbrojtja e të drejtave të anëtarëve të kolektivit, organizimi i festave dhe ceremonive kolektive e nëpër familjet, si me rastin e daljes në pension të mësuesve etj.

3

Mësues, nxënës e prindër sivjet do të vazhdojnë të punojnë për të arritur objektivat e caktuara: "Për një shkollë ndryshe. Tek ne fillon e ardhmja. Të zbatojmë programin për arsimin e detyruar 9-vjeçar. Braktisja të mbetet në shifrën zero...".

Me veprimtari të përbashkëta të kolektivit të kësaj shkolle, vëmendja e të gjithëve do të përqendrohet për vënjen në jetë të programeve parësore të DA, që janë:

-Edukimi i qytetarisë europiane; edukimi mjedisor; edukimi ndërkulturor; edukimi me të drejtat e njeriut e të fëmijëve; edukimi ligjor; edukimi për paqen dhe zgjidhjen e konflikteve; këshillimi i karrjerës; informatizimi i procesit mësimor-edukativ.

Sukseset e deritanishme janë bazë dhe siguri që dëshirat dhe objektivat në shkollën 9-vjeçare "Naim Frashëri" të Tiranës do të arrihen më së miri edhe në vitin e ri arsimor 2005-2006. Natyrisht, këtë gjë e dëshirojnë dhe e presin të gjithë nxënësit, mësuesit e prindërit dhe tërë komuniteti.

...Kësaj radhe shkruam vetëm për një shkollë, në ditët e para të mësimeve. Por fjalë të tilla dhe vlerësime pozitive për punën e arritjet e kolektivave të mësuesve e nxënësve, meritojnë shumë shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, në kryeqytet e në shkallë vendi. Si deri tani, për ato do të vazhdojmë të shkruajmë e të flasim herë pas here, në faqet e revistës sonë "Tribuna sindikale".

MURAT GECAJ

Të reja shkencore

Kepuce grash me taka te levizeshme



Kepucet qe pershtaten lehtesisht jane nje lloj i ri kepucesh per gra, te cilat kane taka qe mund te ndryshohen shume shpejt pa ndonje problem. Ato kombinojne bukur e ne menyre funksionale komoditetin e kepuceve te sheshta, me forma shume te bukura kepucesh me taka te larta. Ato jane perfekte per grate qe preferojne te perdorin kepuce me taka, kur jane ne zyre, ose ne ambiente te tjera, nderkohe qe pelqejne kepuce me te rehateshme, pa taka, kur levizin ne rruge. Kursimi i vendit ne dollapet ose ndarjet qe perdoren si magazina ne shtepi, si edhe ulja e shpenzimeve, duke blere nje pale kepuce, me te dyja funksionet, ne vend te dy paleve, respektivisht me dhe pa taka, jane dy nga epesite me te rendeshishme te kesj shpikjeje. Ato, gjithashtu, eliminojne bezdine e mbjajtjes me vete te dy pale kepuceve, atyre me taka te larta dhe kepuceve te tenisit/pa taka. Eshte e mundur qe keto kepuce te prodhohen ne forma pa fund te stleve te modes se fundit, duke u kombinuar edhe me elemente artizanale.
Patenta tashme eshte gati.

Fiksues shkalle



Eshte nje mekanizen qe ju krijon mundesine per te fiksuar e siguruar shkallen ne nje ndertese ose ne nje srukture tjeter ku juve ju duhet te ngjiteni, duke parandaluar demtimin e kanalit te rrjedhjes se ujrave, ne rastin kur ju punoni ne çati. Ky eshte nje mjet qe jep nje siguri te madhe gjete punes ne shtepi ose ne bizneset tuaja. Mjafton qe ta intalosh njehere ne nje vend te perhershem e te sigurte per t'u ngjitur ne maj te nderteses suaj. Ate mund ta çmontosh shume kollaj dhe shkalla te leviz e te fiksohet ne nje vend tjeter, ku ju paraqitet nevoja. Fiksimi i shkalles mund te sigurohet ne shumicen e ndertesave, me ose pa kanale per rrjedhjen e ujrave, ne çisterna te larta ose ne shtylla te ndryshme. Ky produkt eshte ne proces prodhimi pergatitjeje per shitje.

Kase per te fshehur kompjuterin dhe aksesoret e tij



Tani ju mund te fshihni per bukuri kompjuterin tuaj brenda banakeve, tavolinave te punes, tavolinave te kafese etj, nepermjet nje kase te posaçme kompjeteri. Ne te mund te sistemohet nje kompjuter standard me ekran te sheshte. Kompjuteri, se bashku me tastjeren, kabllet etj, mund te fshihen brenda pak sekondave, duke e lene te lire tavolinen e punes, nese ju nuk kini ndermend te punoni per nje kohe te caktuar, ose mund te shfaqen ne tavoline, po kaq shpejt, nese ju duhet te filloni punen perseri.
Eshte nje pajisje ideale per ne shtepi, ne zyre, ne jahte, ne hotele, fjetore ose ne vende pritjeje.
Patenta nuk eshte leshuar akoma.

Njeriu i padukshem



Harry Poter nuk eshte akademiku i vetem i cili perdor nje pelerine qe e bene ate te padukshem. Nje profesor ne Universitetin e Tokios ka krijuar nje sistem kamuflazhi optik qe e ben gjithesecilin te padukshem, nese vesh nje mantel te veçante reflektues. Ne vijim, shpjegohet se si realizohet nje gje e tille: nje video kamera rregjistron skenen reale qe ekziston mbrapa subjektit dhe e transmeton kete imazh ne nje projektor te instaluar perball, i cili e shfaq skenen ne materialin reflektues. Ky sistem prodhohet per t'u perdorur per qellime ushtarake, por ai mund te perdoret edhe ne kabinat e avionve per t'ua lehtesuar aviatoreve procesin e uljes se avioneve ne toke.pozicionin e parashutistit modifikon rrymen e ajrit per te zvogeluar shpejtesine e renies. Kur vjen koha per t'u ulur ne toke, parashutisti ekthen dorezen e parashutes si zakonisht.

Disa keshilla per te qene rezultativ nen presion

Bota aktuale e punes karakterizohet nga shpejtesia e veprimeve dhe afatet kohore te percaktuara. Punonjesit perballen me ngarkesa te medha ne pune dhe orar te zgjatur. Si rezultat, tani me teper se kurre, suksesi ne pune varet nga aftesia e secilit per te qene rezultativ edhe pse nen presion.
Ja disa keshilla per ta realizuar kete gje:

- **Ecni sipas rrymes.** Pershtatshmeria eshte nje aftesi e paçmueshme.Nese proritetet ndryshojne dhe bossi juaj ju kerkon qe te livizni nga nje projekt tek nje tjeter, perqafojeni sfiden e re dhe demonstroni aftesine tuaj per te mesuar menjehere. Mos harroni; nese ju jeni gjithmone fleksible,(i ndryshueshem), ju asnjehere nuk do te jeni jasht forme.
- **Synoni te sqaroheni.** Mos kini frike te beni shume pyetje. Nese nje njoftim per nje detyre te re ju vjen pa pritur, eshte ne te miren tuaj te sqaroni me menaxherin tuaj, para se te filloni punen, çeshtjet qe kane te bejne me kohen, me ato qe ju personalisht prisni nga detyra e re dhe me synimet e pergjitheshme ne lidhje me te.
- **Percaktoni proritetet, pastaj strategjite.** Harxhoni disa momente per te hartuar nje plan veprimi, perpara se te zhyteni ne brendine e nje projekti. Duke menduar taktikisht dhe duke percaktuar nje rruge drejt fundit qe duket perpara, ju mund te evitoni pengesa te ndryshme, perpara se ato te ngadalesojne punen tuaj. Nje plan mund t'ju ndihmoje, gjithashtu, qe te jeni me mendje te kthjellte gjate gjithe procesit.
- **Mos i zvarrisni gjerat.** Te shqetesohesh ne lidhje me nje projekt nuk eshte e njejta gje si te punosh me te. Me mire se te neglizhosh afatet me te domosdoshme, beso se ato mund t'i realizosh. Te ambientuarit shpejt me detyre e re, para se gjthah do te ndikoje ne uljen e nivlit te stresit dhe do te beje qe te gjitha synimet tuaja t'ju duken me te menaxhueshme.
- **Perpiquni te jeni gjakftohte.** Edhe njerezit me te sjellshem e me te rregullt mund te behen nervoze e te sillen me gjaknxehtesi kur jane te tensionuar. Mos i kontribuoni atmosferes se tensionimit. Edhe pse nuk eshte kurdohere e lehte, perpiquni te shmangni kritikat ne ditet e tensionimit te madh. Mendohuni perpara se te flisni dhe mos i lejoni vetes te ndikoheni nga sjellja e pakujdesdhme e ndonje tjetri.
- **Kerkoni ndihme.** Edhe pse mund te jeni i talentuar dhe mund te beni perpjekje herkuliane (shume te medha), disa detyra nuk mund te kryhen nga nje person i vetem. Neqoftese ju jeni duke bere gjithcka qe eshte e mundeshme per t'u realizuar nje detyre dhe parashikoni ndonje problem, kerkoni ndihme. Percaktoni ceshtjet qe mund te delegohen dhe kerkoni mbeshtetje nga eprori juaj. Atij ose asaj do t'i pelqente me dhume qe te siguronte burime shtese per t'ju ndimuar se sa te merrnin vesh me vone ne lidhje me moszbatimin ne
- **Stimuloni sjellje te mira midis kolegesh.** Eshte gjithmone nje levizje e zgjuar te ndertosh mardhnie te mira me koleget e punes. Nese nje kolege eshte ne afatet e fundit te kohes se plotesimit te nje detyre dhe ka akoma shume pune per te bere, ofrojini atij ndihme, nese kini mundesi per ta ndihmuar. Duke e ndihmuar ne kete moment ka mundesi qe ju te beni nje aleate, i cili do t'ua ktheje favorin nje here tjeter kur ju e jeni ne nevoje.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

